



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

NR. 102 VENDIMI

Tiranë, më 04.02.2019

VENDIM

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare
Xhensila Pine	Relatore

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore Olsida Goxhaj; pas shortimit të shpërndarjes së çështjes dhe caktimit të kryesuesit dhe relatorit, sot, më datë 25.01.2019, ora 15:45, në sallën nr.1 të selisë së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

Z. Metush SARAÇI - gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë

BAZA LIGJORE : Neni 179/b, pika 3, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni G i Aneksit Kushtetues, neni 14 e 57 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

ARSYET PËR NDËRPRERJEN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT:

Subjekti i rivlerësimit, z. Metush Saraçi, ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Subjekti i rivlerësimit, z. Metush Saraçi, ka dhënë dorëheqjen nga detyra që ushtronte, duke e paraqitur këtë dorëheqje, me shkrim, të regjistruar me aktin nr. 3225 prot., datë 12.11.2018.

Neni G i Aneksit Kushtetues ka parashikuar mundësinë e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit si vijon:

“Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.

Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare”.

Neni 64, germa a), e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se një nga mënyrat e mbarimit të statusit të magjistratit është dorëheqja.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, nëpërmjet shkresës nr.3225 prot., datë 09.01.2019, i ka njoftuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit vendimin nr. 10, datë 27.12.2018, me të cilin ka vendosur deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak dorëheqjeje, të gjyqtarit Metush Saraçi.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit Kushtetues dhe neneve 14 e 57 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për z. Metush Saraçi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, është ndërprerë.
2. Të deklarojë humbjen e së drejtës të subjektit të rivlerësimit për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet z. Metush Saraçi, Komisionerëve Publikë dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

4. Ankimi kundër këtij vendimi bëhet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

ROLAND ILIA
Kryesues

XHENSILA PINE

Relatore

GENTA TAFA (BUNGO)

Anëtare

OLSIDA GOXHAJ

Sekretare gjyqësore

Ky vendim u shpall në datën 04.02.2019